



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Blerje autoveture për nevojat e Bashkisë**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **34100000-8**

VLERA E FONDIT LIMIT: **2 900 000 (dymilion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH,**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Për pikën a.- në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26; për pikën b.-në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar, nëse operatori ekonomik ofertues, është kualifikuar për kriteret e përgjithshme të kualifikimit, të përshkruara në pikën 1, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të dorëzuar prej tij, në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiros vjetore të për vitet financiare 2022, 2023,2024, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e ulët se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e vitit 2024.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2024 **(në seksion të veçantë nga taksat dhe detyrimet tatimore në formularin e deklarimit nr.8).**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik, në përputhje me kuadrin ligjor për taksat dhe tarifave vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme:

Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerë jo më e ulët se 20 % të fondit limit që prokurohet. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata me institucionet shtetërore për përvojën e mëparshme duhet të paraqiten vërtetime realizimi të lëshuara nga institucionet perkatese me të cilat keni realizuar kontratën, ku shënohen datat, shumat, sasite dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të firmosura dhe të konfirmuara nga bleresi dhe shitesi ku të përcaktohen qarte, datat, shumat, sasite dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Kërkesat e cilësisë dhe standarteve

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e ndërtimit, si më poshtë **ose ekuivalente me to:**

- Certifikate ISO 9001:2015

(Sistemi i menaxhimit të cilësisë)

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet

ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1.

AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Shënim: Çertifikatat e mesiperme/ekuivalente duhet të jene të leshuar nga Institucione të certifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato nderkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë keto certifikata në përputhje me shërbimet që ka marrë persiper në marreveshjen e bashkepunimit.

2.3.3. Dokumentet për automjetet të targuar/patarguar

Për automjetin e patarguar duhet të paraqiten :

- Dokumenti i zhdoganimit (DAV) të lëshuar nga Dogana Shqipëtare (original).
- Dokumentin ose dokumentat e fitimit të pronësise në njëren nga format që parashikon Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Dokumentin shoqërues, prejardhës, me treguesit teknike të mjetit, në original.
- Kontratë sigurimi të detyrueshëm (Polica e Sigurimit TPL).
- Mjeti të shoqërohet me foto

Ose

Për automjetin e patarguar duhet të paraqiten :

- Leje Qarkullimi
- Police sigurimi TPL, e vlefshme për vitin 2025-2026
- Çertifikata e kontrollit teknik, e vlefshme për vitin 2025-2026.
- Dokumentin shoqërues, prejardhës, me treguesit teknike të mjetit, në original.
- Mjeti të shoqërohet me foto

Shënim: Në rast se dokumentet e mësipërme nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79, si dhe VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i

ndryshuar, neni 40 pika 6, b/c, AK kërkon që OE duhet të dorëzojë si dëshmi të mallit, foto dhe dokumente të tjera nga institucione të autorizuar.

2.3.4. Garancia e automjetit

Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in Fletë Garancinë e Automjetit për një periudhë deri në një vit pa limit km që do të mbulojë mbi defektet e mundshme në motor dhe kambio. Shitësi do të përgjigjet për riparimin e defekteve jo më vonë se tre ditë nga njoftimi. Defektet e shkaktuara nga drejtuesi i mjetit nuk janë përgjegjësi e shitësit. Përcaktimi i shkakut në rast defekti do të identifikohet nga një ekspert i cili do të zgjidhet me miratimin e palëve. Operatori/et ekonomike duhet të deklarojë/në kushtet teknike të garancisë dhe shërbimet e përfshira brënda periudhës së garancisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik, si dhe në nenin 32 të Ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, dhe Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in Fletë Garancinë e Automjetit për një periudhë deri në një vit pa limit km që do të mbulojë mbi defektet e mundshme në motor dhe kambio nga momenti i levrimit të mallit.

2.3.5. Dorëzimi i automjetit

Operatori/et ekonomike duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mjetit pranë Autoritetit Kontraktor do ta shoqërojë atë me:

- Çertifikatën e pronësisë së mjetit (në emër të AK)
- Lejen e qarkullimit të mjetit (në emër të AK)
- Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (në emër të AK)
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike (në emër të AK)
- Shpenzimet për kalimin në pronësi të AK të mbulohen nga operatori ekonomik që do të shpallet fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 40 pika 6, b/c. Ky kriter garanton AK për mallin e kërkuar si dhe i mundëson përdorimin e menjëhershëm të automjetit të kërkuar për nevoja të AK.

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet Teknike

Specifikimet janë hartuar nga Ing. Mekanik i kontraktuar nga AK për këtë object prokurimi, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për hartimin e specifikimeve teknike të automjetit inxhinieri është mbështetur dhe ka patur si reference natyrën e punës dhe aktivitetin për të cilin kërkohet të blihet ky autojmet. Qëllimi i blerjes së këtij automjeti është që ai do të jetë në shërbim të administratës për plotësimin e nevojave të lëvizjeve në zbatimin e detyrave funksionale të sektorëve të ndryshëm. Gjithashtu janë përcaktuar kufij dhe parametra minimalë për sa iu përket përmasave të autoveturës. Në këtë mënyrë specifikimet teknike janë gjithë përfshirëse dhe në përputhje të plotë me kërkesat e institucionit në raport me aktivitetin funksional që ky automjet do të kryejë

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të DST-ve të ngarkuara në SPE për procedurën respektive. Fondi Limit i përlogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të prevetivit të përgatitur nga inxhinieri mekanik i kontraktuar për këtë qëllim, në bazë të ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”, Neni 34, 35, 36 Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 76, i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka miratuar preventivin për fondin limit dhe specifikimet Teknike, dhe është në fazën e prokurimit të projektit.

Si rrjedhojë, kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e realizuar, pasi specifikimet janë hartuar dhe miratuar paraprakisht.

Përfundime

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte të Tenderit, për procedurën “E Hapur, E Thjeshtuar”, e tipit “Mallra”, me objekt prokurimi “**Blerje autoveture për nevojat e Bashkisë**”.

Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Ernest Ymeri

Arbëri Lame

Jona Koçi
